

SUELA KOÇA (PICI), VASILIKA POJANI

**TRAJTIMI I TOGFJALËSHIT TË QËNDRUESHËM NË TEKSTE TË
GJUHËS SHQIPE TË CIKLIT 9-VJEÇAR**

Abstrakt: Synimi i këtij punimi është të analizojë togfjalëshat e qëndrueshëm (frazelogjikë dhe jofrazelogjikë) që nxënësit e shkollës 9-të vjeçare hasin ndërsa praktikojnë aftësinë e të lexuarit në tekstet shkollore të gjuhës shqipe. Meqenëse togfjalëshat e qëndrueshëm nuk kanë kuptim të fjalëpërfjalshëm, ata paraqesin vështirësi reale për nxënësit e rinj. Nëpërmjet këtij punimi, synojmë të shqyrtojmë ndërtimin gramatikor dhe kuptimin specifik të tyre, klasifikimin dhe shpeshtësinë e përdorimit në tekstet përkatëse, shkallën e vështirësisë në të kuptuarit e tyre dhe vëmendjen që u kushtohet nga hartuesit e teksteve mësimore. Ne do të përpiqemi të japim disa sugjerime mbi klasifikimin dhe përdorimin e tyre, faktorët sociolinguistikë dhe gjuhësorë që duhet të merren parasysh në trajtimin e tyre.

I. Hyrje

Përdorimi i ‘togfjalëshave të qëndrueshëm’ qofshin këta frazeologjikë ose jo, e bën më të bukur dhe interesant ligjërimin e folur apo të shkruar. Në mënyrë që këta togfjalësha të përdoren drejt, më parë, duhet të njihen e përvetësohen. Burim parësor janë tekstet e gjuhës shqipe të ciklit 9-vjeçar për nxënësit tanë. Ndër togfjalëshat e qëndrueshëm në letërsinë tonë gjuhësore në mënyrë më të hollësishme janë studiuar togfjalëshat frazeologjikë...¹ prandaj edhe fokus i punimit tonë do të jenë togfjalëshat e qëndrueshëm frazeologjikë (njësitë apo shprehjet frazeologjike, siç emërtohen zakonisht edhe në tekstet shkollore), por nuk do të lemë jashtë vëmendjes sonë edhe shembuj të togfjalëshave të qëndrueshëm jofrazelogjikë si edhe shprehjet me kuptim të figurshëm. Shtysën për të trajtuar këtë çështje e kemi marrë nga artikulli “Frazelogjia në tekstet e gjuhës shqipe dhe leximit letrar” të gjuhëtarit Ali Jashari² për të parë se si ka ndryshuar raporti i njohurive mbi frazeologjinë në tekstet e gjuhës shqipe sot, në krahasim me tekstet në të shkuarën (para viteve ’90).

II. Përshkrimi i të togfjalëshave frazeologjikë dhe analiza e problemeve kryesore

Para se të fillonim me përshkrimin, do të donim të përmendnim se, meqenëse në shkollat tona nuk ka një tekst të përbashkët për mësimin e gjuhës shqipe, ne kemi përzgjedhur për të analizuar serinë e librave “Gjuha shqipe” të

¹ A. Duro, *Termtat togfjalësh*, në “Termi dhe fjala në gjuhën shqipe”, Tiranë, 2009, f. 149.

² Botuar në revistën *Gjuha jonë* 3, 1989, f. 63-71.

shtëpisë botuese Albas, me autor kryesor Rita Petro dhe një sërë bashkautorësh të tjerë, sipas teksteve të ndryshme.

Njohuritë e para për togfjalëshat frazeologjikë jepen që në klasën e tretë. Në librin “Gjuha shqipe 3”³ në rubrikën “Shprehjet frazeologjike” jepet një tekst i shkurtër me vetëm tri njësi të përdorura duke dhënë edhe shpjegimin: *hap sytë – zgjohet, solli gëzim – gëzoi, nuk ia ndan sytë – e shikon*. Më pas jepet edhe përkufizimi: *fjalët në shprehjet frazeologjike përdoren gjithmonë së bashku dhe kanë kuptimin e një fjale të vetme*. Ky përkufizim është i drejtë duke pasur parasysh moshën e fëmijëve, nivelin e tyre si edhe faktin që ata ndeshen për herë të parë me këtë dukuri gjuhësore. Pastaj vazhdohet me tri ushtrime për t’u praktikuar. Në fletoren e punës⁴ që shoqëron këtë libër nuk gjenden ushtrime me togfjalësha të qëndrueshëm të asnjë lloji, gjë që nuk na duket aspak e drejtë, sepse njohuritë teorike duhen zhvilluar më tej në praktikë. Vetëm kështu fëmijët mund t’i kuptojnë dhe përdorin më mirë.

Në tekstet e leximit në “Gjuha shqipe 4”⁵ gjejmë shembuj togfjalëshash të qëndrueshëm frazeologjikë dhe jofrazeologjikë të shpjeguar në fjalorthin e secilit prej teksteve si: *rimar veten (bëhem përsëri mirë)* (f. 21), *me zë të prerë (me një zë të rreptë që nuk pranon ta kundërshtosh)*, *e merr me nge (e merr pa u ngutur, bën diçka me ngadalë, me qetësi, shtruar)* (f. 27), *u ra si bombë (u erdhi e papritur)* (f. 32) etj. Ky numër është shumë i vogël në krahasim me numrin e teksteve që përfshihen në libër gjatë gjithë vitit shkollor. Nëse këto shprehje nuk përdoren, ato nuk kanë asnjë vlerë, sepse shumë shpejt mund të harrohen. Duhet përmendur se, në këtë tekst, shprehjet frazeologjike apo të figurshme nuk përmenden fare dhe nuk gjejmë asnjë ushtrim apo detyrë për to. Njohuritë duhet të jenë në vazhdimësi, të paktën nëpërmjet ushtrimeve apo përdorimit të këtyre togfjalëshave në shkrime të nxënësve. Në fletoren e punës⁶, nga ana tjetër, gjejmë disa ushtrime ku nxënësit duhet të dallojnë togjet me kuptim të figurshëm nga ato me kuptim jo të figurshëm, p.sh. *Ti e ke gjuhën e gjatë / Nxirre gjuhën, - tha mjeku, Të gjithë në shtëpi i mbajnë krahun vëllait të vogël / Dritoni kishte vrarë krahun e djathtë, Sa s’më ra pika / Pikat e shiut binin me zhurmë / Një pikë loti i shkau nënës në fytyrë* etj. Në ushtrimin tjetër nxënësve u kërkohet të shkruajnë fjali ku fjalët *zemër* dhe *dorë* të përdoren me kuptim të figurshëm dhe jo të figurshëm.

Në tekstet, që nxënësit duhet të lexojnë në librin “Gjuha shqipe 5”⁷, gjejmë një sërë shprehjesh të përdorura, por jo të shpjeguara si: *i hedh një sy* (f. 14), *(nuk) më mbushej mendja* (f. 17), *e dëgjonte motrën sy e veshë* (f. 18) e

³ R. Petro dhe N. Pepivani, Ribotim 2012, f. 209.

⁴ R. Petro dhe N. Pepivani, Ribotim 2010.

⁵ R. Petro dhe N. Pepivani, Ribotim 2013.

⁶ R. Petro dhe N. Pepivani, Ribotim 2013, f. 36.

⁷ R. Petro dhe N. Pepivani, Ribotim 2011.

ndonjë tjetër. Edhe këtu numri është shumë i vogël, aq më tepër që edhe nuk shpjegohen. Mbetet detyrë e mësuesit t'u edukojë nxënësve vëmendjen dhe të nxitë interesin e tyre për pasurinë frazeologjike të gjuhës. Gjithashtu, jepet një ushtrim në të cilin nxënësit duhet të zëvendësojnë shprehjet frazeologjike të dhëna me fjalë të tjera, si: *nuk e hapa gojën (nuk foli fare)* dhe të tjerat: *provova të hapja gojë, m'u zgjidh gjuha, bëra të flas* (f. 51). Në vijim të njohurive mbi frazeologjinë (f. 53) jepet një tekst ku janë përdorur pesë shprehje, të cilat nxënësit duhet t'i zëvendësojnë me një fjalë të vetme: *më ngriu gjaku, më mbeti fjala në buzë, hapja gojë, u tret si kripa në ujë, m'u zgjidh gjuha (fola)*. Më pas jepet përkufizimi: **këto grupe fjalësh quhen shprehje frazeologjike. Ato kanë kuptim, kur përdoren së bashku dhe mund të zëvendësohen me një fjalë të vetme.** Po kështu vazhdohet duke përmendur se shprehjet frazeologjike e pasurojnë të folurin tonë duke e bërë më shprehës. Shkrimtarët i përdorin shprehjet frazeologjike për ta pasuruar krijimin e tyre me sa më shumë kuptime dhe emocione. Vëmë re se termi "togfjalësh" nuk përdoret fare. Autorët u referohen atyre si grupe fjalësh, ndoshta në analogji edhe me gjuhët e tjera perëndimore si anglishtja "word group", apo ndonjë gjuhë tjetër. Ky përkufizim nuk është se sjell ndonjë gjë të re në krahasim me përkufizimin e dhënë në klasën e tretë, dhe jep vetëm dy tipare të shprehjeve frazeologjike: *qëndrueshmërinë* dhe *zëvendësimin* me një fjalë të vetme. Pas shpjegimit vijnë edhe ushtrimet. Ndër të tjera, një prej ushtrimeve ka vlerë të veçantë, sepse nxënësve u kërkohet të përdorin fjalorin dhe kjo ka shumë rëndësi edhe për më vonë. Në ushtrimin 8 (f. 55) nxënësve u kërkohet të gjejnë tri shprehje frazeologjike në tekstin "Ah, këto vajzat..." po kështu, në dialogun ndërmjet Pipit dhe djemve ka disa shprehje frazeologjike, që përdoren në të folurin e përditshëm nga fëmijët e asaj moshe. Nxënësit duhet të gjejnë shprehje si: *t'ia ndreqim mirë qejfin, s'hahet fare, pesë me një* etj. (f. 60). Ky është një ushtrim me vlerë, sepse i referohet shprehjeve të përdorura nga vetë fëmijët. Do të ishte mirë të kishte më tepër ushtrime të këtij lloji me karakter praktik dhe me të cilat fëmijët argëtohen shumë. Kërkesa e ushtrimit 12 (f. 98) është që nxënësit të shkruajnë me fjalë të tjera shprehjet e mëposhtme: *me gjysmë zëri, nuk e bën fjalën dysh dhe para të shkoqura*. Të njëjtën kërkesë ka edhe ushtrimi 9 (f. 154) dhe shprehjet janë: *zemra na dërrmonte brinjët, u nisëm me të katra, e humba fare dhe m'u këput diçka brenda kraharorit*. Edhe ushtrimi 9 (f. 176) ka të njëjtën kërkesë, vetëm se këtu shprehjet quhen të figurshme: *hapet qielli, dita që zhdukur, dielli u fsheh dhe i gufoi zemra*. Këtu duhet të bëhet dallimi, sepse këto janë shprehje me kuptim të figurshëm, por nuk janë shprehje frazeologjike që mund të zëvendësohen me një fjalë të vetme. Në pjesën teorike mbi njohuritë për grupin e kryefjalës dhe kallëzuesit (f. 190) mund të shtohet, ndër të tjera, që si kryefjala dhe kallëzuesi shprehen edhe me togfjalësha frazeologjike, kështu nxënësit do të mund të mësonin diçka të re rreth tyre në lidhje me funksionin

gramatikor të shprehjeve frazeologjike dhe t'i paraprinin njohurive më të thelluara rreth tyre më vonë.

Në fletoren e punës⁸ gjejmë 5 ushtrime mbi shprehjet frazeologjike. Duke u bazuar te mosha e nxënësve dhe niveli i tyre, mendojmë se këto lloj ushtrimesh janë të përshtatshme dhe shumë të vlefshme.

Në tekstet për t'u lexuar në "Gjuha shqipe 6"⁹ gjejmë shembuj të përdorimit të togfjalëshave frazeologjike dhe për secilin prej tyre është dhënë shpjegimi si: *ia ka ënda (i pëlqen, ka dëshirë)*, *marr zotim (vendos prerë për diçka)* (f. 31), *e kishte syrin pishë (shihnte shumë mirë)* (f. 43), *më pyeti gjerë e gjatë (më pyeti me hollësi, për çdo gjë)*, e shumë të tjera. Dhënia e shpjegimit është shumë e rëndësishme, edhe numri dhe llojshmëria e togjeve, është i mjaftueshëm, vetëm se nuk thuhet asgjë për ndërtimin e tyre. Nuk kemi shpjegime teorike të mëtejshme, ndërsa përsa i përket ushtrimeve mbi frazeologjinë gjejmë këto tipe, si: Ushtrimi 10 (f. 14) u kërkon nxënësve të shpjegojnë si i kuptojnë këto shprehje: *nuk ia mbushën syrin dhe u bëmë pishman*, kurse ushtrimi 11 (f. 28) u kërkon të mësojnë disa shprehje ku kuptimin kryesor e mban fjala "sy" dhe pastaj të shkruajnë me fjalë të tjera kuptimin e tyre: *ia zuri syri (e pa rastësisht)*, *i hodhi një sy (e pa pa kujdes)*, *e do si sytë e ka halë në sy, e pa me tjetër sy etj.*, apo: Shpjegoni me fjalët tuaja këto shprehje (ushtrimi 12, f. 57): *bridhte ku t'i tekej, rrinin hundë e buzë dhe mbeti shtang*. Kërkesa e ushtrimit 11 (f. 130) është se si mund të shkruhen ndryshe këto shprehje: *mos më bjer në qafë, i hipi gjaku në kokë, u hodhën në krahët e njëri-tjetrit dhe të ka larë me lot*. Ushtrimi 4 (f. 291) është paksa më i veçantë, sepse u kërkon nxënësve të zëvendësojnë rrethanorët e shprehur me shprehje frazeologjike me ndajfolje ose me emër me parafjalë si: *shkel e shko, mbarë e prapë, me zemër të hapur, sa për katër dhe pa dorashka*. Por, mendojmë se duhet të ketë ushtrime të tjera të këtij tipi me shprehje emërore, foljore, etj., duke u treguar nxënësve për një veçori tjetër të togfjalëshave frazeologjike, pikërisht ndarjen e tyre sipas vlerës leksiko-gramatikore. Në fletoren e punës¹⁰, nuk gjejmë asnjë ushtrim për togfjalëshat e qëndrueshëm (frazeologjike ose jo).

Edhe në tekstet e leximit të "Gjuha shqipe 7"¹¹ gjejmë shprehje frazeologjike të shpjeguara si: *është i dalldisur për libra (i do shumë librat)*, *i vjen për dore (di të bëjë mirë diçka)* (f. 15), *s'ua mbajti (kishin frikë)*, *kishte marrë përpjestime (kishte marrë përmasa të mëdha)* (f. 19), *afër menç (s'do mend, sigurisht)* (f. 23), e ndonjë tjetër. Edhe këtu nuk kemi ndonjë shtjellim teorik të mëtejshëm, gjë që nuk na duket normale, sepse deri tani nxënësit dinë

⁸ R. Petro dhe N. Pepivani. Ribotim 2010, f. 18.

⁹ R. Petro, N. Pepivani dhe A. Çerpja, Ribotim 2011.

¹⁰ N. Pepivani dhe A. Çerpja, Ribotim 2010.

¹¹ R. Petro, I. Metani, A. Çerpja dhe Sh. Vreto, Ribotim 2011.

vetëm që shprehjet frazeologjike zëvendësohen me një fjalë të vetme dhe përdoren së bashku si njësi të qëndrueshme e të pandashme. Këtu gjejmë një sërë ushtrimesh që, në fakt, janë më të shumta në krahasim me librat e sipërpërmendur. Ushtrimi 10 (f. 21) thotë: Gjyshja është një personazh i këtij tregimi (Kthimi në shtëpi). Në fjalët e saj ka disa shprehje që i përdorin edhe gjyshet e tjera. Gjejini ato, p.sh.: *mor, të keqen gjyshja, na dukej shtëpia bosh, djalë e kishim si flori, s'më hynte gjë në sy, lëre se ç'hoqëm ne, as punë as katra*n. Edhe ky ushtrim është interesant. Nxënësit mund të pyesin gjyshërit e tyre apo prindërit për shprehje të tjera, që ata përdorin. Në ushtrimin 11 (f. 25) nxënësit u kërkohet të shkruajnë shprehjet e mëposhtme me fjalë të tjera: *përfaqe të zezë, nuk bien poshtë, m'u mbush mendja*. Të njëjtën kërkesë ka edhe ushtrimi 7 (f. 66): *e qeshura vesh më vesh, zemrën time ma ndreq*, po kështu edhe ushtrimi 11 (f. 101): *i dhashë fjalën, e morën nëpër këmbë, i iku gjaku, i erdhi zemra në vend, të kam vëlla e shkuar vëllaut*. Pas kësaj nxënësit duhet të thonë se cilat nga këto shprehje janë të kundërta me njëra-tjetrën dhe cilat kanë kuptim të njëjtë. Edhe në ushtrimin 11 (f. 123) përbri shprehjeve të dhëna duhet të shkruhen shprehje me kuptim të kundërt: *ia do të keqen, nuk është mirë, i humbi nga sytë, i ranë këmbët*. Këto ushtrime janë të vlefshme, sepse nxënësit mësojnë se sinonimia dhe antonimia mund të shprehen edhe me njësi frazeologjike. Në ushtrimin 10 (f. 141) nxënësit duhet që, pasi të kenë shpjeguar kuptimin e shprehjeve, t'i mësojnë ato: *notova në tym (notova pa e ditur se ku shkoja, kot së koti), qesha në tym, eca në tym, fola në tym*, dhe njëkohësisht duhet të shkruajnë në fletore shprehje të tjera nga teksti (Në qytetin e liliputëve). Në gramatikat e shqipes këto njësi trajtohen si lokucione ndajfoljore.¹² Kjo duhet t'u bëhet e ditur nxënësit për të mos i ngatërruar me shprehjet frazeologjike që kanë strukturë togfjalëshi dhe përbëhen nga të paktën dy fjalë shënuese.¹³ Ushtrimi 8 (f. 233) është paksa i veçantë, sepse nxënësit duhet të formojnë fjali ku njësitë frazeologjike duhet të përdoren si përcaktorë kallëzuesor të kryefjalës: *me gisht në gojë, thëngjill i mbuluar, i rrahur me vaj dhe me uthull, sheqer e mjaltë*. Këto ushtrime janë shumë të vlefshme dhe duhet të jenë më të shpeshta, sepse lidhen me faktin se shumë prej njësive frazeologjike ka mundësi të përdoren në fjali si gjymtyrë të vetme, si kryefjalë, plotës etj.¹⁴ Në rubrikën “Fjalëformim dhe Leksikologji” (f. 277) në ushtrime të ndryshme gramatikore gjenden fjali që përmbajnë togfjalësha të qëndrueshëm frazeologjikë dhe jofrazeologjikë si: *Pasqyra e Dëshirave* (f. 135), *Tryeza e Rrumbullakët* apo *e Bukura e Dheut* (f. 216). Këto të fundit përdoren si emra të përveçëm (shkruhen me shkronjë të madhe), gjithmonë

¹² *Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe* II, Tiranë: IGjL, 1976, f. 18-19.

¹³ J. Thomai, *Çështje të frazeologjisë së gjuhës shqipe*, Tiranë, 1981, f. 126.

¹⁴ S. Floqi, *Çështje të teorisë së togfjalëshit në shqipen e sotme*, SF, 1986/1.

bashkë, dhe emërtojnë sende, njerëz, apo vende. Në fletoren e punës¹⁵ gjenden vetëm dy ushtrime për njësitë frazeologjike. Në ushtrimin 5, nxënësve u kërkohet të shkruajnë shpjegimin që gjetën në “Fjalorin e Shqipes së Sotme”, 2002, për njësitë frazeologjike: *e ka halë në sy, me gjak të ngrirë, heq udhën dhe ece jak*. Kurse në ushtrimin 6 u kërkohet të gjejnë dhe të shkruajnë në “Fjalorin e Shqipes së Sotme”, 2002, njësitë frazeologjike me fjalën *e aftë* dhe *zemër*.

Njohuritë për njësitë frazeologjike zgjerohen mjaft në librin “Gjuha shqipe 8”¹⁶ sepse në rubrikën “Leksikologjia” jepet një panoramë, pak a shumë, e plotë për njësitë frazeologjike dhe veçoritë, përkufizimin dhe klasifikimin duke dhënë edhe shembuj konkretë për ilustrim (f. 224-225). Njëkohësisht jepen edhe disa veçori dalluese të tyre nga grupet e lira të fjalëve. Përkufizimi i dhënë është si më poshtë: *Njësitë frazeologjike janë bashkime të qëndrueshme fjalësh të formuara historikisht dhe për një kohë të gjatë, të përbëra nga dy ose më shumë fjalë shënjuese e që kanë vlerën e një fjale të vetme*. Termi duhet unifikuar, këtu quhen njësi dhe jo shprehje frazeologjike. Njëkohësisht jepet edhe klasifikimi i tyre në njësi frazeologjike **emërore, mbiemërore, foljore** e **ndajfoljore** (duke dhënë kështu vetëm klasifikimin sipas funksionit që ato kanë në fjali, por autorët nuk japin klasifikimin e tyre sipas shkallës së motivimit). Autorët tregojnë edhe për ngjashmërinë e tyre me proverbat, fjalët e urta dhe gjëegjëzat, por këto të fundit dallohen prej njësive frazeologjike, sepse kanë vlerë fjalie dhe jo fjale (*Kush punon ha. S’mbahet shtëpia me miell hua. Guri i rëndë në vend të vet.* etj.). Në vijim të njohurive teorike pasojnë tetë ushtrime me kërkesa të ndryshme mbi frazeologjinë. Të gjitha këto ushtrime lidhen me konkretizimin e njohurive teorike, por edhe këtu trajtohet vetëm një aspekt i njësive frazeologjike, ai leksikor dhe jo aspekti gramatikor apo funksioni që ato kanë në fjali.

Ndryshe nga librat e mësipërm, në tekstet e të cilëve jepen shprehje të ndryshme bashkë me shpjegimin përkatës, këtu nuk kemi diçka të tillë. Në pjesën e leximit kemi vetëm tri ushtrime me shprehje frazeologjike. Me interes është ushtrimi 5 (f. 207), sepse nxënësit duhet të formojnë fjali ku njësitë frazeologjike duhet të përdoren si përcaktorë kallëzuesorë të kryefjalës: *me gojë hapur, dhëlpër plakë, thëngjill i mbuluar, i rrahur me vaj dhe me uthull, me krahë hapur*. (një ushtrim të tillë e hasëm edhe në “Gjuha shqipe 7” [ushtrimi 8, f. 233]). Edhe në këtë libër gjejmë shembuj të togfjalëshave të qëndrueshëm jofrazeologjikë si: *Liqeni i Luleve* (f. 21), *e Bukura e Dheut* (f. 183) dhe *Aleksandi i Madh* (f. 166). Edhe këtyre togfjalëshave duhet t’u

¹⁵ A. Çerpja dhe I. Metani. Ribotim 2010, f. 53.

¹⁶ R. Petro, I. Metani dhe A. Çerpja. Ribotim 2012.

kushtohet vëmendje, pasi edhe ata mund të kenë funksione të ndryshme në fjali si kryefjalë, kundrinë, apo plotës¹⁷.

Edhe në tekstin “Gjuha shqipe 9”¹⁸ nuk gjejmë togfjalësha frazeologjike të shpjeguar në fjalorthin e secilës prej tyre. Në të (f. 185) gjejmë të përdorur togun *Zonja e Parë* dhe më pas, në ushtrime të llojeve të ndryshme gjejmë fjali ku janë përdorur shprehje të ndryshme frazeologjike si: *m'u prish mendja* (f. 190), *ia kishin punuar pas krahëve* (f. 191) etj., por, në fakt, nuk kemi asnjë ushtrim të mirëfilltë mbi frazeologjinë. Në fletoren e punës¹⁹ gjenden tek-tuk togfjalësha frazeologjike të përfshirë në ushtrime të ndryshme. Në ushtrimet për rrethanorët, ndër të tjera, gjejmë edhe fjalinë: *Shikonim me gojë hapur* (f. 46) ku nxënësit duhet të thonë me se shprehen rrethanorët.

III. Përfundime

Disa nga problemet që vërejtëm lidhen me konceptin për frazeologjinë gjuhësore, me vëllimin e lëndës, me llojin e njësive që sillen si shembuj, me zgjedhjen e ushtrimeve etj.

Së pari, vihet re se termi “togfjalësh” nuk është përdorur aspak, dhe këtu i referohemi jo vetëm togfjalëshave të qëndrueshëm, por edhe atyre të lirë. Thjesht është përdorur termi “grup” qoftë ky emëror, mbiemëror, foljor, etj. Dihet që në librat e gramatikës së gjuhës shqipe përdoret termi “togfjalësh”. Edhe në emërtim, siç duket nga rastet e dhëna, ato quhen herë “shprehje frazeologjike” apo të figurshme, herë “njësi frazeologjike”. Por nga shembujt e cituar shohim se jo të gjitha janë të figurshme apo frazeologjike, ato janë thjesht togfjalësha të qëndrueshëm dhe si të tillë nuk bëhet dallimi nga njësi të tjera. Koncepti për frazeologjinë gjuhësore duhet të përshkojë dijet që jepen në shkollë për këtë kategori, jo vetëm në teori, por edhe në praktikë (nëpërmjet shembujve dhe ushtrimeve). Ndonjëherë duket sikur njohuritë janë të përsëritura dhe jepen të njëjtët shembuj për ilustrim. Nxënësit duhet të përvetësojnë tiparet kryesore të këtyre njësive, larminë e ndërtimit të tyre (si togfjalësha apo fjali), kuptimin e njësuar dhe të figurshëm, rendin e ngulitur të gjymtyrëve të tyre, përdorimin si barasvlerëse të një fjale të vetme, etj. Këto njohuri duhet të jenë në vazhdimësi, ashtu si gjithë njohuritë e tjera që marrin nxënësit. Çdo vit ata diskutojnë dhe trajtojnë të njëjtat probleme për pjesët e ndryshme të ligjëratës: përemrat vetorë, emrat dhe kategoritë e tyre, mbiemrat, foljet dhe kategoritë e tyre, kohët, mënyrat, etj. Ato trajtohen me hollësi në seksionet përkatëse të gramatikës (morfologjisë apo sintaksës) dhe shoqërohen me shumë ushtrime ilustruese, gjë që nuk ndodh me frazeologjinë.

Së dyti, vendi që zë frazeologjia në tekstet e gjuhës shqipe është ende i vogël. Në tekstet për t'u lexuar thjesht jepet një listë me shprehje, herë të

¹⁷ J. Thomai, *Çështje..., vep. e cit.*, Tiranë, 1981, f. 74.

¹⁸ R. Petro, A. Çerpja dhe I. Metani, Ribotim 2009.

¹⁹ A. Çerpja dhe I. Metani, Ribotim 2013.

shpjeguara dhe herë jo, por kjo nuk i ndihmon aspak nxënësit t'i mbajnë mend dhe aq më tepër t'i përdorin. Si rrjedhim, numri duhet të jetë më i madh dhe kjo arrihet jo nëpërmjet teorisë sesa nëpërmjet ushtrimeve praktike, ku të përfshihen njësi që gjenden në fjalorët e gjuhës shqipe, por edhe të tjera që janë me karakter krahinor. Në këtë rast, themi se mbetet detyrë e mësuesit për t'i angazhuar fëmijët në aktivitete apo projekte të ndryshme për grumbullimin e tyre, fjala vjen, nga prindërit, apo nga gjyshërit, etj. Edhe tekstet duhet të jenë më të bukura, ku të spikatë veçanërisht frazeologjia popullore. Po kështu, tekstet duhet të jenë të llojeve të ndryshme, jo vetëm nga letërsia artistike, por edhe nga shkrime politiko-shoqërore, nga folklori, pse jo edhe nga fantashkenca, në mënyrë që nxënësit të bëjnë dallimin midis këtyre stileve dhe çfarë lloj togfjalëshash përdoren në to. Nga ana tjetër, kërkesat e ushtrimeve duhet të jenë më të larmishme, jo thjesht gjeni njësitë frazeologjike, apo zëvendësojini me fjalë apo sinonime etj.

Mësuesit duhet patjetër të nxitin interesin e nxënësve për pasurinë e madhe të këtyre njësive, por, mbi të gjitha, për përdorimin e tyre, si në të folur edhe në punët me shkrim, që ata hartojnë dhe që nuk janë të pakta në numër, por aspak të pasura me këto njësi.

Së treti, e rëndësishme është t'u mësohet nxënësve se këto njësi funksionojnë në gjuhë si barasvlerëse të një fjale të vetme dhe në sintaksë ato analizohen si të tilla. Gjithashtu, nuk thuhet asgjë për ndërtimin e tyre dhe marrëdhëniet sintaksore midis fjalëve përbërëse të tyre si: folje + folje: *qesh e ngjesh, shkel e shko*, folje + emër: *e hëngri çairin, u bë çengel*, emër + emër: *ëndrra në diell, kodra pas bregut*, e shumë të tjera.

Në mbyllje, do të ritheksonim që mësimi dhe përvetësimi i frazeologjisë në shkollë duhet të rritet edhe më shumë si në sasi edhe në cilësi, në përputhje me synimet e programit dhe sipas moshës dhe nivelit të fëmijëve. E rëndësishme është që, kur nxënësit të mbarojnë ciklin 9-vjeçar, të kenë mësuar mjaft njësi frazeologjike dhe të kenë fituar shprehitë e duhura për përdorimin e drejtë dhe me vend të tyre.

BIBLIOGRAFIA

- A. Duro, *Termet togfjalësh*, në *Termi dhe fjala në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2009.
 A. Jashari, *Frazeologjia në tekstet e gjuhës shqipe dhe leximit letrar* në "Gjuha jonë" 3, 1989.
Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe II, Tiranë: IGjL, 1976.
 J. Thomai, *Çështje të frazeologjisë së gjuhës shqipe*, Tiranë, 1981.
 R. Petro, A. Çerpja, N. Pepivani dhe I. Metani, *Seria e librave "Gjuha shqipe 3-9"* shoqëruar nga librat e punës përkatës, Tiranë: Albas, Ribotime 2009-2013.
 S. Floqi, *Çështje të teorisë së togfjalëshit në shqipen e sotme*, SF, nr. 1, 1986.